



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

RREGULLORE (QRK) - NR. 05/2020
PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË ADMINISTRATIVE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT DHE
MINISTRIVE¹

REGULATION (GRK) - NO. 05/2020
ON THE AREAS OF ADMINISTRATIVE RESPONSIBILITY OF THE OFFICE OF THE PRIME
MINISTER AND MINISTRIES²

UREDBA (VRK) - BR. 05/2020
O OBLASTIMA ADMINISTRATIVNE ODGOVORNOSTI KANCELARIJE PREMIJERA I
MINISTARSTAVA³

¹ Rregullorja (QRK) – Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive është miratuar në mbledhjen e 3^{të} të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr. 01/03, datë 19.02.2020.

² Regulation (GRK) - No. 05/2020 on the Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries, was approved on the 3rd meeting of the Government of Kosovo, with the Decision No. 01/03, dated 19/02/2020.

³ Uredba (VRK) - Br. 05/2020 o Oblastima Administrativne Odgovornosti Kancelarije Premijera i Ministarstava, usvojen je na 3 sednicu Vlade Kosova, sa Odlukom Br. 01/03, datum 19.02.2020.

<p>Qeveria e Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 93 (4) dhe nenit 96 (1 dhe 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 dhe 9 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (GZ, Nr. 07/2019, dt. 01.03.2019),</p> <p>Duke marrë parasysh Vendimin (Nr. 07-V-005) e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbledhjes plenare të mbajtur më 03 shkurt 2020, për zgjedhjen e Kryeministrit, të zëvendëskryeminstrove dhe të ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (GZ, Nr.15/2011, dt. 12.09.2011),</p> <p>Nxjerr:</p> <p style="text-align: center;">RREGULLORE (GRK) - NR. 05/2020 PËR FUSHAT E PËRGJEGJËSISË ADMINISTRATIVE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT DHE MINISTRIVE</p>	<p>The Government of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Article 93 (4) and Article 96 (1 and 2) of the Constitution of the Republic of Kosovo, Articles 3 and 9 of Law no. 06/L-113 on Organization and Functioning of State Administration and Independent Agencies (OG, No. 07/2019, dated 01.03.2019),</p> <p>Taking into account the Decision (No. 07-V-005) of the Assembly of the Republic of Kosovo, from the plenary meeting held on 03 February 2020, on the election of the Prime Minister, Deputy Prime Ministers and Ministers of the Government of the Republic of Kosovo, and pursuant to Article 19 (6.2) of the Government's Rules of Procedure no. 09/2011 (OG, No.15/2011, dated 12.09.2011),</p> <p>Issues the following:</p> <p style="text-align: center;">REGULATION (GRK) - NO. 05/2020 ON THE AREAS OF ADMINISTRATIVE RESPONSIBILITY OF THE OFFICE OF THE PRIME MINISTER AND MINISTRIES</p>	<p>Vlada Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 93 (4) i člana 96 (1 i 2) Ustava Republike Kosovo, člana 3. i 9. Zakona br. 06/L-113 o organizaciji i funkcionisanju državne uprave i nezavisnih agencija, (SL, Br. 07/2019, od dana 01.03.2019. godine),</p> <p>Uzimajući u obzir Odluku (Br. 07-V-005) Skupštine Republike Kosovo, sa plenarne sednice održane 03. februara 2020. godine, o izboru Premijera, zamenika premijera i ministara Vlade Republike Kosovo, kao i u skladu sa članom 19 (6.2) Pravilnika o radu Vlade br. 09/2011 (SL, Br. 15/2011, od dana 12.09.2011. godine),</p> <p>Donosi:</p> <p style="text-align: center;">UREDBA (VRK) - BR. 05/2020 O OBLASTIMA ADMINISTRATIVNE ODGOVORNOSTI KANCELARIJE PREMIJERA I MINISTARSTAVA</p>
--	---	---

KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	CHAPTER I – GENERAL PROVISIONS	POGLAVLJE I – OPŠTE ODREDBE
<p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Kjo rregullore përcakton fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive në Qeverinë e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria).</p>	<p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>This Regulation defines the areas of administrative responsibility of the Office of the Prime Minister and of the Ministries in the Government of the Republic of Kosovo (hereinafter: the Government).</p>	<p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>Ova uredba određuje oblasti administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i Ministarstava u Vladi Republike Kosovo (u daljem tekstu: Vlada).</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Dispozitave të kësaj rregulloreje duhet t’u përmbahen: Kryeministri, ministrat, zëvendëskryeministrat, ministrat, zëvendësministrat, këshilltarët politikë, këshilltarët e jashtëm politikë, nëpunësit në kabinete dhe nëpunësit civil në Qeverinë e Republikës së Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p> <p>The provisions of this regulation shall be complied with by: the Prime Minister, Deputy Prime Ministers, Ministers, Deputy Ministers, Political Advisers, Foreign Political Advisers, Cabinet Officers and Civil Servants in the Government of the Republic of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p> <p>Odredbi ove uredbе se trebaju pridržavati: Premijer, zamenici premijera, ministri, zamenici ministara, politički savetnici, spoljni politički savetnici, službenici u kabinetima i državni službenici u Vladi Republike Kosovo.</p>

<p>KAPITULLI II - ANËTARËT E QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS</p> <p>Neni 3 Përbërja e Qeverisë së Republikës së Kosovës</p> <p>Qeverinë e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat.</p> <p>Neni 4 Qeveria</p> <p>1. Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p>2. Qeveria me qëllim të ushtrimit të kompetencave të saj:</p> <p>2.1. merr vendime me propozimin e anëtarëve të Qeverisë dhe institucioneve të tjera në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;</p> <p>2.2. nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;</p> <p>2.3. diskuton probleme dhe merr vendime për çështje të tjera që ajo i konsideron të rëndësishme në kuadër të kompetencave të</p>	<p>CHAPTER II - MEMBERS OF THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF KOSOVO</p> <p>Article 3 Composition of the Government of the Republic of Kosovo</p> <p>The Government is composed of the Prime Minister, Deputy Prime Ministers and Ministers.</p> <p>Article 4 Government</p> <p>1. The Government shall exercise its executive power in accordance with Constitution and legislation in force.</p> <p>2. In order to exercise its competences, the Government shall:</p> <p>2.1. make decisions on the proposal of members of the Government and other institutions in accordance with the Constitution and the legislation in force;</p> <p>2.2. issue legal acts or regulations, necessary for the implementation of laws;</p> <p>2.3. discuss problems and make decisions on other issues that it considers important within its competencies;</p>	<p>POGLAVLJE II – ČLANOVI VLADE REPUBLIKE KOSOVO</p> <p>Član 3 Sastav Vlade Republike Kosovo</p> <p>Vlada se sastoji od Premijera, zamenika premijera i ministara.</p> <p>Član 4 Vlada</p> <p>1. Vlada vrši izvršnu vlast u skladu sa Ustavom i važećim zakonodavstvom.</p> <p>2. Vlada, u cilju vršenja svojih nadležnosti:</p> <p>2.1. donosi odluke na predlog članova Vlade i drugih institucija u skladu sa Ustavom i važećim zakonodavstvom;</p> <p>2.2. donosi pravne akte ili uredbe, neophodne za sprovođenje zakona;</p> <p>2.3. razmatra probleme i donosi odluke o drugim pitanjima koje ona smatra važnim u okviru svojih nadležnosti;</p>
---	---	--

<p>saj;</p> <p>2.4. vendosë për emërimet dhe shkarkimet brenda kompetencave të saj, si dhe</p> <p>2.5. kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Anëtarët e Qeverisë</p> <p>1. Anëtarët e Qeverisë kanë këto kompetenca:</p> <p>1.1. marrin pjesë në mbledhjet e Qeverisë dhe mbështesin punën e saj;</p> <p>1.2. propozojnë iniciativa për përgatitjen e projektligjeve, politika, si dhe propozime të tjera që kanë të bëjnë me fushat e përgjegjësisë administrative të tyre;</p> <p>1.3. marrin pjesë në punën e komisioneve ministrore dhe trupave të tjerë, dhe veprojnë sipas autorizimeve, objektivave dhe qëndrimeve të Qeverisë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.</p>	<p>2.4. decide on appointments and dismissals within its competencies, and</p> <p>2.5. perform all duties and responsibilities set forth in the Constitution and legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Members of the Government</p> <p>1. The members of the Government shall have the following powers:</p> <p>1.1. participate in Government meetings and support its work;</p> <p>1.2. propose initiatives for the preparation of draft laws, policies, and other proposals related to their areas of administrative responsibility;</p> <p>1.3. participate in the work of ministerial committees and other bodies, and act in accordance with the authorizations, objectives and opinions of the Government in accordance with the Constitution and applicable legislation.</p>	<p>2.4. odlučuje o imenovanjima i razrešenjima u okviru svojih nadležnosti, kao i</p> <p>2.5. obavlja sve druge obaveze i odgovornosti određene Ustavom i važećim zakonodavstvom.</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Članovi Vlade</p> <p>1. Članovi Vlade imaju sledeće nadležnosti:</p> <p>1.1. učestvuju na sastancima Vlade i podržavaju njen rad;</p> <p>1.2. predlažu inicijative za pripremanje nacрта zakona, politika, kao i drugih predloga koji se odnose na oblasti njihove administrativne odgovornosti;</p> <p>1.3. učestvuju u radu ministarskih komisija i drugih tela, i deluju u skladu sa ovlašćenjima, ciljevima i stavovima Vlade, u skladu sa Ustavom i važećim zakonodavstvom.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 6 Kryeministri</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Prime Minister</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Premijer</p>
<p>1. Kryeministri në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi:</p> <p>1.1. përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë;</p> <p>1.2. koncepton, propozon dhe zbaton drejtimit kryesorë të politikës shtetërore dhe përgjigjet për to;</p> <p>1.3. bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Qeverisë.</p> <p>2. Në zbatim të kompetencave të tij kushtetuese, Kryeministri:</p> <p>2.1. nxjerr dekrete, vendime, urdhra, rregullore dhe lidh marrëveshje mirëkuptimi/bashkëpunimi;</p> <p>2.2. kërkon nga çdonjëri prej zëvendëskryeministrave dhe ministrave t'i raportojë me gojë apo me shkrim për punën e tij dhe të ministrisë të cilën e kryeson, që t'i ofrojë informata dhe raporte nga fusha e vet e punës si dhe informata të tjera me rëndësi për mbarëvajtjen e punës së Qeverisë;</p> <p>2.3. nëse vlerëson se vendimi i marrë nga Qeveria mund të ketë pasoja të dëmshme, menjëherë, ose jo më vonë se në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë, kërkon që Qeveria</p>	<p>1. In exercising the powers set forth in the Constitution and the legislation in force, the Prime Minister shall:</p> <p>1.1. represent and lead the Government;</p> <p>1.2. conceive, propose, and implement the main directions of state policy and is responsible for them;</p> <p>1.3. coordinate and monitor the work of members of the Government.</p> <p>2. Pursuant to the Constitutional powers, the Prime Minister shall:</p> <p>2.1. issue decisions, orders, regulations and establish memorandums of understanding/cooperation;</p> <p>2.2. request from any Deputy Prime Minister and Minister to report to him orally or in writing on his/her work and on the work of the Ministry which they lead, to provide him/her with information and reports on his/her area of work and other information important for the smooth running of the work of the Government;</p> <p>2.3. immediately, or no later than at the subsequent meeting of the Government, request by the Government to review and amend its decision, if the Prime Minister considers that the decision taken by</p>	<p>1. U vršenju nadležnosti određenih Ustavom i važećim zakonodavstvom, Premijer:</p> <p>1.1. zastupa i vodi Vladu;</p> <p>1.2. osmišljava, predlaže i sprovodi glavne pravde državne politike i odgovara za iste;</p> <p>1.3. koordinira i kontroliše rad članova Vlade.</p> <p>2. U vršenju svojih ustavnih nadležnosti, Premijer:</p> <p>2.1. Izdaje dekrete, odluke, naloge, uredbe i sklapa sporazume o razumevanju /saradnji;</p> <p>2.2. zahteva od svakog zamenika premijera i ministra da usmeno ili pismeno izveštava o svom radu i radu ministarstva kojim predsedava, da pruža informacije i izveštaja iz svoje oblasti rada i druge informacije koje su od značaja za napredak rada Vlade;</p> <p>2.3. ukoliko smatra da odluka donesena od strane Vlade može imati štetne posledice, odmah, ili najkasnije do održavanja naredne sednice Vlade, traži</p>

<p>ta rishqyrtojë dhe ta ndryshojë vendimin e saj. Zbatimi i këtij vendimi pezullohet derisa Qeveria ta trajtojë kërkesën e Kryeministrit;</p> <p>2.4. Nëse vlerëson se vendimi i marrë apo akti nënligjor i nxjerrë nga zëvendëskryeministri apo ministri mund të ketë pasoja të dëmshme apo është i kundërligjshëm, menjëherë kërkon që të njëjtin ta shfuqizojë, në të kundërtën, merr vendim për anulimin apo shfuqizimin e tij;</p> <p>2.5. i raporton Kuvendit në mënyrë periodike, ndërsa me kërkesë të Kuvendit, i raporton për aktivitetet e Qeverisë apo të ministrisë së caktuar, duke përfshirë shfrytëzimin e të gjitha fondeve të pranuar;</p> <p>2.6. siguron se ka komunikim efektiv të politikave dhe të aktiviteteve qeveritare për qytetarët e Republikës së Kosovës;</p> <p>2.7. nënshkruan aktet juridike të nxjerra nga Qeveria dhe siguron zbatimin e tyre;</p> <p>2.8. zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve të Qeverisë, zëvendësministrave dhe ndërmjet anëtarëve të Qeverisë dhe zëvendësministrave;</p> <p>2.9. emëron dhe shkarkon anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësministrat;</p>	<p>the Government may have damaging consequences. Implementation of this decision shall be suspended until the Government addresses the request of the Prime Minister;</p> <p>2.4. if the Prime Minister considers that the decision taken or the sub-legal act issued by the Deputy Prime Minister or Minister may have harmful consequences or is unlawful, he/she shall immediately request that it be repealed, otherwise, he/she shall take a decision for its cancellation or repeal;</p> <p>2.5. report to the Assembly periodically, whilst with the request of the Assembly, report on activities of the Government or the Ministry concerned, including the use of all funds received;</p> <p>2.6. ensure that there is effective communication of Government policies and activities for citizens of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.7. sign the legal acts issued by the Government and ensure their implementation;</p> <p>2.8. resolve disagreements between Members of the Government, Deputy Ministers and between Members of the Government and Deputy Ministers;</p> <p>2.9. appoint and dismiss Members of the Government and Deputy Ministers;</p>	<p>od Vlade da ponovo razmotri i izmeni svoju odluku. Sprovođenje ove odluke se suspenduje sve dok Vlada ne tretira zahtev Premijera;</p> <p>2.4. ukoliko proceni da odluka ili podzakonski akt donesen od strane zamenika premijera ili ministra može imati štetne posledice ili je protivzakonit, odmah zahteva da se isti stavi van snage, u suprotnom, donosi odluku o njegovom poništenju ili stavljanju van snage;</p> <p>2.5. podnosi Skupštini periodične izveštaje, dok na zahtev Skupštine, izveštava o aktivnostima Vlade ili određenog ministarstva, uključujući korišćenje svih primljenih fondova;</p> <p>2.6. obezbeđuje postojanje efikasne komunikacije vladinih politika i aktivnosti za građane Republike Kosovo;</p> <p>2.7. potpisuje pravne akte izdate od strane Vlade i obezbeđuje njihovo sprovođenje;</p> <p>2.8. rešava nesporazume između članova Vlade, zamenika ministara i između članova Vlade i zamenika ministara;</p> <p>2.9. imenuje i razrešava članove Vlade i zamenike ministara;</p>
--	---	--

<p>2.10. kryen edhe punë të tjera, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Zëvendëskryeministri</p> <p>1. Zëvendëskryeministri gjatë ushtrimit të kompetencave të tij:</p> <p>1.1. ndihmon Kryeministrin në caktimin e prioriteteve, në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të Qeverisë;</p> <p>1.2. me autorizim të Kryeministrit mund të ushtrojë kompetenca që me ligj i janë dhënë Kryeministrit;</p> <p>1.3. me autorizim të Kryeministrit e zëvendëson atë në rast të mungesës;</p> <p>1.4. ushtron detyra të tjera, të cilat i caktohen nga Kryeministri;</p> <p>1.5. kryen detyra të tjera që përcaktohen me ligje të veçanta.</p> <p>2. Nëse emërohen më shumë se një zëvendëskryeministër, njëri nga ta emërohet zëvendëskryeministër i parë. Zëvendëskryeministrat e tjerë emërohen sipas radhës.</p> <p>3. Zëvendëskryeministri i parë koordinon</p>	<p>2.10. perform other duties as defined by the Constitution and the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Deputy Prime Minister</p> <p>1. During the exercise of his/her powers, the Deputy Prime Minister shall:</p> <p>1.1. assist the Prime Minister in setting priorities, developing and implementing Government policies;</p> <p>1.2. with the authorization of the Prime Minister, may exercise powers conferred by law to the Prime Minister;</p> <p>1.3. replace the Prime Minister in case of their absence, with authorization by the Prime Minister;</p> <p>1.4. perform other duties assigned by the Prime Minister;</p> <p>1.5. perform other duties prescribed by special laws.</p> <p>2. If more than one Deputy Prime Minister is appointed, one of them shall be appointed as first Deputy Prime Minister. The other Deputy Prime Ministers shall be appointed by order.</p> <p>3. The First Deputy Prime Minister coordinates work</p>	<p>2.10. obavlja i druge poslove, određene Ustavom i važećim zakonodavstvom.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Zamenik premijera</p> <p>1. U vršenju svojih nadležnosti, Zamenik premijera:</p> <p>1.1. pomaže Premijeru u određivanju prioriteta, u razvoju i sprovođenju Vladinih politika;</p> <p>1.2. uz ovlašćenje Premijera, može da obavlja nadležnosti koje su zakonom date Premijeru;</p> <p>1.3. uz ovlašćenje Premijera, zamenjuje ga u slučaju odsustva;</p> <p>1.4. obavlja druge obaveze, koje mu se određuju od strane Premijer;</p> <p>1.5. obavlja druge obaveze koje se određuju posebnim zakonima.</p> <p>2. Ukoliko je imenovano više od jednog Zamenika premijera, jedan od njih se imenuje za prvog zamenika premijera. Ostali zamenici premijera se imenuju po redosledu.</p> <p>3. Prvi zamenik premijera koordiniše rad sa</p>
---	---	---

<p>punën me zëvendëskryeministrat dhe i raporton Kryeministrit.</p> <p>4. Fusha e përgjegjësisë administrative të zëvendëskryeministrit të parë dhe të zëvendëskryeministrave përcaktohen me vendim të Kryeministrit.</p> <p>5. Zëvendëskryeministri është përgjegjës për një fushë me rëndësi të veçantë ose prioritet të lartë për Qeverinë dhe mund të përfshijë koordinimin e një fushe të politikave që është në kuadër të përgjegjësisë administrative të disa ministrive.</p> <p>6. Zëvendëskryeministrit mund t'i jepet mandati për një ministri.</p> <p>7. Zëvendëskryeministri i cili është përgjegjës për një ministri duhet t'i mbajë dy sferat e përgjegjësisë administrative të veçanta.</p> <p>8. Zëvendëskryeministri informon paraprakisht Kryeministrin për vizitat jashtë vendit dhe i raporton me shkrim apo me gojë, jo më vonë se pesë (5) ditë pas realizimit të tyre.</p>	<p>with the Deputy Prime Ministers and reports to the Prime Minister.</p> <p>4. Areas of responsibility of the First Deputy Prime Minister and Deputy Prime Ministers shall be determined by a decision of the Prime Minister.</p> <p>5. The Deputy Prime Minister is responsible for a special importance or high priority area for the Government and may include coordination of a policy area that is within the administrative responsibility of several ministries.</p> <p>6. The Deputy Prime Minister may be given the mandate for one ministry.</p> <p>7. The Deputy Prime Minister who is responsible for a Ministry should hold two separate spheres of administrative responsibility.</p> <p>8. The Deputy Prime Minister shall inform the Prime Minister in advance of the visits abroad and shall report in writing or orally, not later than five (5) days after their realization.</p>	<p>zamenicima premijera i izveštava Premijeru.</p> <p>4. Oblast administrativne odgovornosti Prvog zamenika premijera i Zamenika premijera određuju se odlukom Premijera.</p> <p>5. Zamenik premijera je odgovoran za oblast od posebnog značaja ili od visokog prioriteta Vlade i može obuhvatati koordiniranje jedne oblasti politika koja je u okviru administrativne odgovornosti nekoliko ministarstava.</p> <p>6. Zameniku premijera se može dati mandat za jedno ministarstvo.</p> <p>7. Zamenik premijera koji je odgovoran za jedno ministarstvo treba da snosi dve posebne sfere administrativne odgovornosti.</p> <p>8. Zamenik premijera obaveštava unapred Premijera o posetama van zemlje i podnosi pismeni ili usmeni izveštaj, najkasnije pet (5) dana nakon njihove realizacije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Ministri</p> <p>1. Ministri, në pajtim me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, politikat dhe udhëzimet e përcaktuara nga Qeveria apo Kryeministri:</p> <p>1.1. udhëheq dhe përfaqëson ministrinë;</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Minister</p> <p>1. In accordance with the constitution, the applicable legislation, policies and directives set by the Government or the Prime Minister, the Minister shall:</p> <p>1.1. lead and represent the ministry;</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Ministar</p> <p>1. Ministar, u skladu sa Ustavom, važećim zakonodavstvom, politikama i uputstvima određenim od strane Vlade ili Premijera:</p> <p>1.1. zastupa i vodi ministarstvo;</p>

<p>1.2. i përgjigjet Kryeministrit dhe i raporton Kuvendit për çështjet që kanë të bëjnë me ministrinë që e udhëheq;</p> <p>1.3. propozon projektligje në kuadër të fushës së përgjegjësisë administrative të ministrisë dhe përcakton orientimin politik të punës së saj;</p> <p>1.4. nxjerr vendime dhe akte nënligjore dhe lidhë marrëveshje mirëkuptimi/bashkëpunimi në kuadër të fushës së përgjegjësisë administrative të ministrisë; dhe</p> <p>1.5. kryen detyra të tjera në kuadër të fushës së përgjegjësisë administrative të ministrisë, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.</p> <p>2. Gjatë kryerjes së përgjegjësisë dhe funksioneve të tij, ministri kujdeset që ministria që e udhëheq:</p> <p>2.1. të hartojë dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave të ministrisë;</p> <p>2.2. të planifikojë qartë buxhetin dhe formulojë prioritetet për ndarjen e mjeteve financiare, që i vihen në dispozicion nga Buxheti i Kosovës dhe nga burime të tjera;</p> <p>2.3. të sigurojë ndarjen më të përshtatshme, transparente dhe të përgjegjshme të fondeve që i marrin nga Buxheti i Kosovës</p>	<p>1.2. respond to the Prime Minister and the Assembly on issues relating to his/her Ministry;</p> <p>1.3. propose draft laws within the area of administrative responsibility of the Ministry and define the political orientation of its work;</p> <p>1.4. issue decisions and sub-legal acts and establish memorandums of understanding/cooperation within the area of administrative responsibility of the Ministry; and</p> <p>1.5. perform other duties within the area of administrative responsibility of the Ministry, as defined by the legislation in force.</p> <p>2. During the performance of his/her responsibilities and functions, the Minister shall ensure that his/her Ministry:</p> <p>2.1. drafts and monitors the implementation of the policies of the Ministry;</p> <p>2.2. clearly plans the budget and formulates priorities for the allocation of funds, which are available from Kosovo budget and other sources;</p> <p>2.3. ensures the most appropriate, transparent and accountable allocation of funds received from the Kosovo budget and other sources;</p>	<p>1.2. odgovara Premijeru i podnosi izveštaj Skupštini o pitanjima koja se odnose na ministarstvo koje vodi;</p> <p>1.3. predlaže nacрте zakona u okviru oblasti administrativne odgovornosti ministarstva i određuje političku orijentaciju njenog rada;</p> <p>1.4. donosi odluke i podzakonske akte i sklapa sporazume o razumevanju/saradnji u okviru oblasti administrativne odgovornosti ministarstva; i</p> <p>1.5. obavlja druge obaveze u okviru oblasti administrativne odgovornosti ministarstva, određenih važećim zakonodavstvom.</p> <p>2. Tokom obavljanja svojih odgovornosti i funkcija, ministar obezbeđuje da ministarstvo koje vodi:</p> <p>2.1. izradi i nadgleda sprovođenje politika ministarstva;</p> <p>2.2. jasno planira budžet i formuliše prioritete za raspodelu finansijskih sredstava, koje su joj na raspolaganje od strane Budžeta Kosova i drugih izvora;</p> <p>2.3. obezbeđuje najprikladniju, transparentnu i odgovornu raspodelu fondova dobijenih od starne Budžeta</p>
--	---	--

<p>dhe nga burime të tjera;</p> <p>2.4. të sigurojë shërbime të besueshme, transparente, të përgjegjshme dhe jo diskriminuese;</p> <p>2.5. të merr masa për parandalimin e mashtrimit dhe korrupsionit.</p> <p>3. Ministri është përgjegjës që:</p> <p>3.1. të merr pjesë në mbledhjet e Qeverisë dhe të trupave të saj të punës, aty ku është anëtar;</p> <p>3.2. të informojë paraprakisht Kryeministrin për vizitat jashtë vendit dhe të raportojë me shkrim apo me gojë, jo më vonë se pesë (5) ditë pas realizimit të tyre;</p> <p>3.3. të njoftojë paraprakisht Kryeministrin dhe Qeverinë si dhe Ministrinë përgjegjëse për Punët e Jashtme për çdo nismë të ministrive për marrëveshje ndërkombëtare në pajtim me legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare;</p> <p>3.4. të njoftojë Kryeministrin dhe Qeverinë për çdo nismë të ministrive për marrëveshje të bashkëpunimit/mirëkuptimit;</p> <p>3.5. të njoftojë paraprakisht Kryeministrin dhe Qeverinë për organizime të ngjarjeve të rëndësishme dhe të raportojë me shkrim, jo më vonë se pesë (5) ditë pas mbarimit të tyre;</p>	<p>2.4. provides reliable, transparent, accountable and non-discriminatory services;</p> <p>2.5. undertakes measures to prevent fraud and corruption.</p> <p>3. Also, Minister shall be responsible to:</p> <p>3.1. participate in sessions of the Government and its working bodies of which he/she is a member;</p> <p>3.2. inform in advance the Prime Minister for visits abroad and report, in written or verbally, not later than five (5) days after the visits;</p> <p>3.3. inform in advance the Prime Minister, the Government and the Ministry responsible for Foreign Affairs of any initiative of ministries for international agreements in compliance with the legislation applicable to international agreements;</p> <p>3.4. inform the Prime Minister and the Government of any initiative of ministries for cooperation/understanding agreements;</p> <p>3.5. inform in advance the Prime Minister and the Government of organization of important events and report in written not later than five (5) days after those events;</p>	<p>Kosova i drugih izvora;</p> <p>2.4. obezbeđuje pouzdane, transparentne, odgovorne i nediskriminatorne usluge;</p> <p>2.5. preduzima mere za sprečavanje obmanjivanja i korupcije.</p> <p>3. Ministar je odgovoran da:</p> <p>3.1. učestvuje na sednicama Vlade i njenih radnih tela, tamo gde je član;</p> <p>3.2. obaveštava unapred Premijera o posetama van zemlje i podnosi pismeni ili usmeni izveštaj, najkasnije pet (5) dana nakon njihove realizacije;</p> <p>3.3. obaveštava unapred Premijera i Vladu kao i odgovorno Ministarstvo za spoljne poslove o svakoj inicijativi ministarstava za međunarodne sporazume u skladu sa važećim zakonodavstvom o međunarodnim sporazumima;</p> <p>3.4. obaveštava Premijera i Vladu o svakoj inicijativi ministarstava za sporazum o saradnji/razumevanju;</p> <p>3.5. obaveštava unapred Premijera i Vladu o organizovanju važnih događaja i podnosi pismeni izveštaj, najkasnije pet (5) dana nakon njihovog završetka;</p>
---	---	---

<p>3.6. të sigurojë se politikat ministrore janë komunikuar dhe diskutuar qartë dhe efektivisht me publikun dhe palët e interesit;</p> <p>3.7. t'i raportojë Kryeministrit dhe Qeverisë në mënyrë periodike, ndërsa me kërkesë të Kryeministrit, raporton për aktivitetet e ministrisë, duke përfshirë shfrytëzimin e të gjitha burimeve të pranuar;</p> <p>3.8. të njoftojë Kryeministrin dhe Qeverinë për të gjitha aktet juridike të nxjerra.</p> <p>4. Ministri ushtron edhe detyra të tjera, me të cilat ngarkohet nga Qeveria apo Kryeministri.</p>	<p>3.6. ensure that ministerial policies are clearly and efficiently communicated to and discussed with the public and stakeholders;</p> <p>3.7. report to the Prime Minister and the Government periodically, whereas, upon the request of the Prime Minister, report on activities of the ministry, including the use of all resources received;</p> <p>3.8. inform the Prime Minister and the Government of all legal acts issued.</p> <p>4. Minister shall also exercise other duties as assigned by the Government or the Prime Minister.</p>	<p>3.6. obezbeđuje da su ministarske politike komunicirane i jasno i efikasno raspravljane sa javnošću i zainteresovanim stranama;</p> <p>3.7. podnosi Premijeru i Vladi periodične izveštaje, dok na zahtev Premijera, izveštava o aktivnostima Ministarstva, uključujući korišćenje svih primljenih fondova;</p> <p>3.8. obaveštava Premijera i Vladu o svim donesenim pravnim aktima.</p> <p>4. Ministar obavlja i druge obaveze, kojima se zadužuje od strane Vlade ili Premijera.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Mungesa apo pamundësia e përkohshme e veprimit e Kryeministrit</p> <p>1. Në rast të mungesës apo pamundësisë së përkohshme të veprimit të Kryeministrit, ai zëvendësohet nga zëvendëskryeministri i parë.</p> <p>2. Në rast të mungesës së Kryeministrit dhe zëvendëskryeministrit të parë, Kryeministri autorizon zëvendëskryeministrin në rradhë.</p> <p>3. Në situatat nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, zëvendëskryeministri ushtron detyrat e</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Absence or inability of the Prime Minister to act</p> <p>1. In case of absence or temporary inability of the Prime Minister to act, he/she shall be replaced by the first Deputy Prime Minister.</p> <p>2. In case of absence of the Prime Minister and first Deputy Prime Minister, the Prime Minister shall authorize the subsequent Deputy Prime Minister.</p> <p>3. In situations referred to in paragraph 1 and 2 of this Article, the Deputy Prime Minister shall discharge</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Odsustvo ili privremena sprečenost delovanja Premijera</p> <p>1. U slučaju odsustva ili privremene sprečenosti delovanja Premijera, njega zamenjuje Prvi zamenik premijera.</p> <p>2. U slučaju odsustva Premijera i Prvog zamenika premijera, Premijer ovlašćuje sledećeg po redu Zamenika premijera.</p> <p>3. U situacijama iz stava 1. i 2. ovog člana, zamenik premijera obavlja određene obaveze</p>

<p>caktuara derisa mungesa apo pamundësia e përkohshme e veprimit të pushojë së ekzistuari.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Mungesa ose pamundësia e përkohshme e veprimit e një ministri</p> <p>1. Në rast të mungesës ose pamundësisë së përkohshme të veprimit të ministrit, ai zëvendësohet nga zëvendësministri i parë.</p> <p>2. Në rast të mungesës së ministrit dhe zëvendësministrit të parë, Kryeministri autorizon zëvendësministrin në radhë.</p> <p>3. Në situatat nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, zëvendësministri ushtron detyrat e caktuara derisa mungesa apo pamundësia e përkohshme e veprimit të pushojë së ekzistuari.</p>	<p>assigned duties until the absence or temporary inability ceases.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Absence or temporary inability of the Minister to act</p> <p>1. In case of absence or temporary inability of the Minister to act, he/she shall be replaced by the first Deputy Minister.</p> <p>2. In case of absence of the Minister and first Deputy Minister, the Prime Minister shall authorize the subsequent Deputy Minister.</p> <p>3. In situation referred to in paragraph 1 and 2 of this Article, the Deputy Minister shall discharge assigned duties until the absence or temporary inability to act ceases.</p>	<p>sve dok ne prestaje postojanje odsustva ili privremene sprečenosti delovanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Privremena odsutnost ili sprečenost delovanja jednog ministra</p> <p>1. U slučaju privremene odsutnosti ili sprečenosti delovanja ministra, njega zamenjuje prvi zamenik ministra.</p> <p>2. U slučaju odsutnosti ministra i prvog zamenika ministra, premijer ovlašćuje sledećeg zamenika ministra.</p> <p>3. U situacijama iz stava 1. i 2. ovog člana, zamenik ministra vrši određene dužnosti sve dok privremena odsutnost ili sprečenost delovanja ne prestane da postoji.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Zëvendësministri</p> <p>1. Zëvendësministri emërohet nga Kryeministri për mbështetjen e ministrit. Ai është përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve në fushat e përcaktuara nga ministri përkatës.</p> <p>2. Nëse për një ministri emërohen më shumë se një zëvendësministër, njëri nga ta emërohet zëvendësministër i parë. Zëvendësministrat e tjerë emërohen sipas radhës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Deputy Minister</p> <p>1. Deputy Minister shall be appointed by the Prime Minister to support the Minister. He/she shall be responsible to manage activities in the areas determined by the relevant Minister.</p> <p>2. If more than one Deputy Minister is appointed to one Ministry, one of them shall be appointed as first Deputy Minister. Other Deputy Ministers shall be appointed in sequence.</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Zamenik ministra</p> <p>1. Zamenika ministra imenuje premijer radi podrške ministru. On je odgovoran za upravljanje aktivnostima u oblastima koje je odredio dotični ministar.</p> <p>2. Ako je u jednom ministarstvu imenovano više od jednog zamenika ministra, jedan od njih se imenuje za prvog zamenika ministra. Ostali zamenici ministra se</p>

<p>3. Zëvendësministri i parë koordinon punën me zëvendësministrat dhe i raporton ministrit.</p> <p>4. Zëvendësministri gjatë ushtrimit të kompetencave të tij:</p> <p>4.1. ndihmon ministrin në caktimin e prioriteteve, në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të ministrisë;</p> <p>4.2. me autorizim të ministrit mund të ushtrojë kompetenca që me ligj i janë dhënë ministrit;</p> <p>4.3. ushtron detyra të tjera, të cilat i caktohen nga ministri.</p>	<p>3. First Deputy Minister shall coordinate the work with the Deputy Ministers and shall report to the Minister.</p> <p>4. When exercising his/her competences, the Deputy Minister:</p> <p>4.1. shall assist the Minister in setting priorities and development and implementation of policies of the Ministry;</p> <p>4.2. upon authorization by the Minister, may exercise competences vested on the Minister by law;</p> <p>4.3. shall exercise other duties, as assigned by the Minister.</p>	<p>imenuju po redu.</p> <p>3. Prvi zamenik ministra koordinira rad sa zamenicima ministra i izveštava ministru.</p> <p>4. Zamenik ministra tokom vršenja svojih dužnosti:</p> <p>4.1. pomaže ministru u određivanju prioriteta, u razvoju i sprovođenju politika ministarstva;</p> <p>4.2. uz ovlašćenje ministra, može vršiti nadležnosti koje su zakonom date ministru;</p> <p>4.3. obavlja i druge poslove koje mu odredi ministar.</p>
<p>KAPITULLI III - ZYRA E KRYEMINISTRIT DHE MINISTRITË</p> <p>Neni 12 Funksionet e Zyrës së Kryeministrit</p> <p>1. Kryeministri udhëheq Zyrën e Kryeministrit.</p> <p>2. Zyra e Kryeministrit përfshin: Kabinetin e Kryeministrit, zëvendëskryeministrat dhe</p>	<p>CHAPTER III – OFFICE OF PRIME MINISTER AND MINISTRIES</p> <p>Article 12 Functions of the Office of Prime Minister</p> <p>1. Prime Minister shall lead the Office of the Prime Minister.</p> <p>2. Office of the Prime Minister shall consist of: Cabinet of the Prime Minister, Deputy Ministers and their advisors, Office of Secretary General, offices and units</p>	<p>POGLAVLJE III – KANCELARIJA PREMIJERA I MINISTARSTVA</p> <p>Član 12 Funkcije Kancelarije premijera</p> <p>1. Premijer vodi Kancelariju premijera.</p> <p>2. Kancelarija premijera obuhvata: Kabinet premijera, zamenike premijera i njihove</p>

<p>këshilltarët e tyre, Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, zyrat dhe njësitë që ushtrojnë përgjegjësitë dhe funksionet e caktuara në Zyrën e Kryeministrit.</p>	<p>discharging responsibilities and functions assigned in the Office of the Prime Minister.</p>	<p>savetnike, Kancelariju generalnog sekretara, kancelarije i jedinice koje vrše određene odgovornosti i funkcije u Kancelariji premijera.</p>
<p>3. Zyra e Kryeministrit koordinon punën e ministrive.</p>	<p>3. Office of the Prime Minister shall coordinate the work of ministries.</p>	<p>3. Kancelarija premijera koordinira rad ministarstava.</p>
<p>4. Zyra e Kryeministrit mbështet veprimtarinë e Qeverisë, Kryeministrit, zëvendëskryeministrave dhe të ministrave dhe është përgjegjëse për:</p>	<p>4. Office of the Prime Minister shall support the activity of the Government, Prime Minister, Deputy Prime Ministers and Ministers and shall be responsible for:</p>	<p>4. Kancelarija premijera podržava delovanje Vlade, premijera, zamenika premijera i ministara i odgovorna je za:</p>
<p>4.1. Përgatitjen e propozimeve të projekt amendamenteve kushtetuese, projektligjeve, projekt akteve nënligjore, koncept dokumenteve (vlerësimi të ndikimit), vlerësimeve ex-post të legjislacionit, dokumenteve strategjike, dhe propozimeve të tjera, nga fushëveprimi i Qeverisë si tërësi dhe i Zyrës së Kryeministrit, si dhe monitoron dhe siguron zbatimin e tyre;</p>	<p>4.1. Preparing proposals of draft constitutional amendments, draft laws, draft bylaws, concept documents (impact assessment), ex-post assessments of legislation, strategic documents and other proposals from the scope of the Government in entirety and Office of the Prime Minister, as well as monitoring and ensuring their implementation;</p>	<p>4.1. Pripremanje predloga za nacрте ustavnih amandmana, nacрта zakona, nacрта podzakonskih akata, koncept dokumenata (procene uticaja), ex-post procena zakonodavstva, strateških dokumenata i drugih predloga iz delokruga Vlade u celini i Kancelarije premijera, kao i prati i osigurava njihovu primenu;</p>
<p>4.2. Hartimin e politikave në sferën e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe në çështjet kundër diskriminimit;</p>	<p>4.2. Drafting policies in the sphere of good governance, human rights, equal opportunities and issues against discrimination;</p>	<p>4.2. Izradu politika u sferi dobrog upravljanja, ljudskih prava, jednakih mogućnosti i u pitanjima protiv diskriminacije;</p>
<p>4.3. Përgatitjen dhe organizimin e mbledhjeve të Qeverisë dhe mbledhjeve tjera të kryesuar nga Kryeministri ose nga një zëvendëskryeministër në emër të tij, si dhe ofrimin e mbështetjes administrative dhe analitike Trupave Qeveritare, dhe mekanizmave të tjerë;</p>	<p>4.3. Preparing and organizing the meetings of the Government and other meetings chaired by the Prime Minister or a Deputy Prime Minister on his/her behalf, as well as providing administrative and analytical support to Government Bodies and other mechanisms;</p>	<p>4.3. Pripremanje i organizovanje sednica Vlade i drugih sednica kojima predsedava premijer ili jedan od zamenika premijera u njegovo ime, kao i pružanje administrativne i analitičke podrške telima vlade i drugim mehanizmima;</p>

<p>4.4. Koordinimin e punës së ministrive për hartimin e legjislacionit, përgatitjen dhe monitorimin e Programit Legjislativ dhe Planit Legjislativ për aktet nënligjore, Programit të Vlerësimit Ex-Post të legjislacionit, shqyrtimin e konsistencës së projekt legjislacionit me kornizën kushtetuese dhe ligjore, kontrollimin e cilësisë së tyre me standardet e hartimit të legjislacionit, si dhe zbatimin dhe monitorimin e tyre;</p> <p>4.5. Koordinimin e punës së ministrive për zhvillimin e koncept dokumenteve (vlerësimit të ndikimit), kontrollimin e cilësisë së tyre, monitorimin e Listës së Koncept Dokumenteve, koordinimin e aspekteve të tjera të Rregullimit më të Mirë; si dhe zbatimin dhe monitorimin e tyre;</p> <p>4.6. Udhëheq koordinimin e hartimit të strategjisë gjithëpërfshirëse për zhvillim dhe koordinon punën e ministrive për hartimin e dokumenteve strategjike të nivelit shtetëror, sektorial/ndërsektorial dhe horizontal, kontrollimin e cilësisë së tyre, monitorimin e Planit të Dokumenteve Strategjike, siguron që prioritetet qeveritare pasqyrohen në planifikimet buxhetore të Qeverisë, si dhe zbatimin dhe monitorimin e tyre;</p> <p>4.7. Shqyrtimin e propozim vendimeve para miratimit nga Qeveria për të siguruar</p>	<p>4.4. Coordinating the work of ministries for drafting the legislation, preparing and monitoring the Legislative Program and Legislative Plan for bylaws, Program for Ex-post Assessment of Legislation, reviewing the consistency of draft legislation with the constitutional and legal framework, checking their quality against standards for drafting of legislation, as well as their implementation and monitoring;</p> <p>4.5. Coordinating the work of ministries for developing concept documents (impact assessment), checking their quality, monitoring the List of Concept Documents, coordinating other aspects of Better Regulation; as well as their implementation and monitoring;</p> <p>4.6. Leads the coordination of drafting of the comprehensive development strategy and coordinates the work of ministries on drafting state, sector / cross-sectoral and horizontal level strategic documents, check their quality, monitoring of the Strategic Document Plan, ensures that government priorities are reflected in budget planning of the Government, as well as their implementation and monitoring;</p> <p>4.7. Reviewing draft decisions prior to the approval by the Government in order to ensure the</p>	<p>4.4. Koordinaciju rada ministarstava za izradu zakonodavstva, pripremanje i praćenje Zakonodavnog programa i Zakonodavnog plana za podzakonske akte, Programa za ex-post procenu zakonodavstva, razmatranje usklađenosti nacрта zakonodavstva sa ustavnim i zakonskim okvirom, kontrolisanje njihovog kvaliteta sa standardima za izradu zakonodavstva, kao i njihovo sprovođenje i praćenje;</p> <p>4.5. Koordinaciju rada ministarstava za razvoj koncept dokumenata (procene uticaja), kontrolisanje njihovog kvaliteta, praćenje Liste koncept dokumenata, koordinaciju ostalih aspekata bolje regulacije; kao i njihovo sprovođenje i praćenje;</p> <p>4.6. Vodi koordinaciju izrade sveobuhvatne strategije razvoja i koordinira rad ministarstava na izradi državnih, sektorskih / međusektorskih i horizontalnih nivoa strateških dokumenata, kontrole kvaliteta, nadgledanja plana strateških dokumenata, osiguravajući da se prioriteti vlade odraze u planiranju budžeta Vlade, kao i njihovu primenu i praćenje;</p> <p>4.7. Razmatranje predloga odluka pre usvajanja u Vladi, kako bi obezbedila</p>
--	--	---

<p>përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi, si dhe monitorimin dhe raportimin e zbatimit të tyre;</p> <p>4.8. Bashkërendimin e zbatimit të Programit të Qeverisë, hartimin e Deklaratës së Prioriteteve, zhvillimin e prioriteteve dhe politikave strategjike të Qeverisë, si dhe zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të tyre;</p> <p>4.9. Koordinimin e punës për përgatitjen e Planit të Punës së Qeverisë me ministritë dhe institucionet e tjera përkatëse, si dhe monitorimin dhe raportimin për zbatimin e tij;</p> <p>4.10. Koordinimin e marrëdhënieve mes Qeverisë dhe Kuvendit, Presidentit, institucioneve të pavarura dhe agjencive të pavarura;</p> <p>4.11. Koordinimin e procesit të bashkëpunimit të Qeverisë me shoqërinë civile dhe përfshirjen e tyre në procesin e hartimit të politikave;</p> <p>4.12. Koordinimin e procesit të konsultimeve ndër-institucionale dhe me publikun gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit;</p> <p>4.13. Koordinimin e komunikimit të Qeverisë me publikun;</p> <p>4.14. Koordinimin e zhvillimit dhe</p>	<p>compliance with the applicable legislation, as well as monitoring of and reporting on their enforcement;</p> <p>4.8. Coordinating the implementation of Government Program, drafting the Statement of Priorities, developing strategic priorities and policies of the Government, and implementing and monitoring their implementation;</p> <p>4.9. Coordinating the work for preparing the Work Plan of the Government with ministries and other relevant institutions, as well as monitoring of and reporting on its implementation;</p> <p>4.10. Coordinating relations between the Government and Assembly, President, independent institutions and independent agencies;</p> <p>4.11. Coordinating the process of cooperation of the Government with civil society and their involvement in the policy drafting process;</p> <p>4.12. Coordinating the process of inter-institutional and public consultations during the drafting of policies and legislation;</p> <p>4.13. Coordinating communication of the Government with the public;</p> <p>4.14. Coordinating the development and monitoring</p>	<p>usklađenost sa važećim zakonodavstvom, kao i praćenje i izveštavanje o njihovom sprovođenju;</p> <p>4.8. Koordinaciju sprovođenja Programa vlade, izradu Izjave o prioritetima, razvoj strateških prioriteta i politika Vlade, kao i sprovođenje i praćenje njihovog sprovođenja;</p> <p>4.9. Koordinaciju rada za pripremu Plana rada Vlade sa ministarstvima i drugim relevantnim institucijama, kao i praćenje i izveštavanje o njihovom sprovođenju;</p> <p>4.10. Koordinaciju odnosa između Vlade i Skupštine, predsednika, nezavisnih institucija i nezavisnih agencija;</p> <p>4.11. Koordinaciju procesa saradnje Vlade sa civilnim društvom i njihovim uključivanjem u procesu izrade politika;</p> <p>4.12. Koordinaciju procesa međuinstitucionalnih i konsultacija sa javnošću tokom izrade politika i zakonodavstva;</p> <p>4.13. Koordinacija komunikacije vlade sa javnošću;</p> <p>4.14. Koordinaciju razvoja i praćenje</p>
---	---	---

<p>monitorimin e zbatimit të politikave që kanë të bëjnë me llogaridhënien dhe transparencën;</p> <p>4.15. Koordinimin me Presidentin, Kuvendin, ministrinë dhe institucionet tjera për publikimin e legjislacionit në Gazetën Zyrtare në pajtim me legjislacionin në fuqi;</p> <p>4.16. Promovimin dhe nxitjen e vetëdijesimit për politikën qeveritare dhe legjislacionin në fuqi, duke përfshirë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;</p> <p>4.17. Ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve tjera të cilat i janë caktuar me ligj, akte nënligjore, vendim të Qeverisë apo vendim të Kryeministrit.</p>	<p>of policies related to the accountability and transparency;</p> <p>4.15. Ensuring coordination with the President, Assembly, ministries and other institutions for publication of legislation in Official Gazette in compliance with the legislation in force;</p> <p>4.16. Promoting and encouraging the awareness-raising for Government policies and legislation in force, including international standards on human rights;</p> <p>4.17. Exercising competences and other functions determined in the law, bylaws, decision of the Government or decision of the Prime Minister.</p>	<p>sprovođenja politika koje se odnose na odgovornost i transparentnost;</p> <p>4.15. Koordinaciju sa Prednikom, Skupstinom, ministarstvima i ostalim institucijama za objavljivanje zakonodavstva u Službenom listu u skladu sa važećim zakonodavstvom;</p> <p>4.16. Promovisanje i podsticanje svesti o vladinim politikama i važećem zakonodavstvu, uključujući međunarodne standarde o ljudskim pravima;</p> <p>4.17. Vršenje drugih nadležnosti i funkcija koje su joj dodeljene zakonom, podzakonskim aktima, odlukom Vlade ili odlukom premijera.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Sekretari i përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 The Secretary General of the Office of the Prime Minister</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Generalni sekretar Kancelarije premijera</p>
<p>1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit është nëpunësi më i lartë civil në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe është zyrtar kryesor administrativ i Zyrës së Kryeministrit.</p> <p>2. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeministrit dhe ushtron detyrën nën drejtimin dhe udhëzimet e</p>	<p>1. The Secretary General of the Office of the Prime Minister shall be the highest civil servant in the Government of the Republic of Kosovo and the chief administrative officer of the Office of the Prime Minister.</p> <p>2. The Secretary General of the Office of the Prime Minister shall report and respond directly to the Prime Minister and exercises the office under the direction and guidance of the Prime Minister.</p>	<p>1. Generalni sekretar Kancelarije premijera je najviši civilni službenik u Vladi Republike Kosovo i glavni je administrativni službenik Kancelarije premijera.</p> <p>2. Generalni sekretar Kancelarije premijera izveštava i odgovara direktno premijeru i vrši funkciju pod vođstvom i uputstvima premijera.</p>

<p>Kryeministrit.</p> <p>3. Sekretari i përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit udhëheqë zyrat dhe njësitë përkatëse të Zyrës së Kryeministrit në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p>4. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit koordinon punën me Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive.</p> <p>5. Sekretari i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore:</p> <p>5.1. mbështet kryeministrin dhe zëvendëskryeministrat në punën e tyre;</p> <p>5.2. siguron koordinimin e hartimit të politikave në Zyrën e Kryeministrit dhe Qeverisë në tërësi;</p> <p>5.3. siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit, të politikave dhe të vendimeve të Kryeministrit dhe të Qeverisë;</p> <p>5.4. siguron drejtimin, koordinimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e Zyrës së Kryeministrit dhe Qeverisë në tërësi;</p> <p>5.5. siguron bashkëpunimin me ministri të tjera dhe institucionet, si dhe me agjencitë e pavarura;</p> <p>5.6. vendos për administrimin e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, të</p>	<p>3. The Secretary General of the Office of the Prime Minister shall lead the respective offices and units of the Office of the Prime Minister in accordance with the relevant legislation in force.</p> <p>4. The Secretary General of the Office of the Prime Minister shall coordinate the work with the Secretary General of the Ministries.</p> <p>5. The Secretary General shall have the following main responsibilities:</p> <p>5.1. supports the Prime Minister and Deputy Prime Ministers in their work;</p> <p>5.2. ensures coordination of policy making in the Office of the Prime Minister and the Government as a whole;</p> <p>5.3. ensures implementation and control of the implementation of the legislation, policies and decisions of the Prime Minister and the Government;</p> <p>5.4. ensures management, coordination, control and supervision of the Office of the Prime Minister and the Government as a whole;</p> <p>5.5. ensures co-operation with other ministries and institutions, as well as with independent agencies;</p> <p>5.6. decides on the management of the financial, material and human resources of the Office of the</p>	<p>3. Generalni sekretar Kancelarije premijera rukovodi odgovarajućim kancelarijama i jedinicama Kancelarije premijera u skladu sa relevantnim važećim zakonodavstvom.</p> <p>4. Generalni sekretar Kancelarije premijera koordinira rad sa generalnim sekretarima ministarstava.</p> <p>5. Generalni sekretar ima sledeće glavne odgovornosti:</p> <p>5.1. podržava premijera i zamenike premijera u njihovom radu;</p> <p>5.2. osigurava koordinaciju izrade politika u Kancelariji premijera i Vlade u celini;</p> <p>5.3. osigurava sprovođenje i kontrolu sprovođenja zakonodavstva, politika i odluka premijera i Vlade;</p> <p>5.4. osigurava vođenje, koordinaciju, kontrolu i nadgledanje Kancelarije premijera i Vlade u celini;</p> <p>5.5. osigurava saradnju sa drugim ministarstvima i institucijama, kao i sa nezavisnim agencijama;</p> <p>5.6. odlučuje o upravljanju finansijskim, materijalnim i ljudskim resursima</p>
--	--	--

<p>Zyrës së Kryeministrit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;</p> <p>5.7. çdo përgjegjësi tjetër, që i caktohet me ligj apo të deleguar shprehimisht nga Kryeministri.</p> <p>6. Sekretari i Përgjithshëm mbështetet nga stafi profesional dhe mbështetës.</p> <p>7. Sekretari i Përgjithshëm, në rast mungese, zëvendësohet nga drejtori i një prej Zyrave të Zyrës së Kryeministrit, i caktuar me shkrim nga vetë Sekretari. Në rast pamundësie shëndetësore, drejtori i zyrës që zëvendëson Sekretarin e Përgjithshëm caktohet me shkrim nga Kryeministri.</p> <p>8. Sekretari i Përgjithshëm mund t'u delegojë detyrat e përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni drejtuesve të zyrave të Zyrës së Kryeministrit. Në këtë rast, ai mbetet përgjegjës për mbikëqyrjen e detyrave të deleguara.</p> <p>9. Sekretari i Përgjithshëm krijon një regjistër, në të cilin përcaktohen aktet e delegimit, detyrat dhe fusha e delegimit, personit të cilit i është deleguar dhe periudha e delegimit</p>	<p>Prime Minister in accordance with the legislation in force;</p> <p>5.7. any other responsibility provided in the law or delegated explicitly by the Prime Minister.</p> <p>6. The Secretary General shall be supported by professional and supportive staff.</p> <p>7. The Secretary General shall, in case of absence, be substituted by the Director of one of the offices within the Office of Prime Minister, assigned in writing by the Secretary himself/herself. In case of inability due to health, the Director of the office substituting the Secretary General is assigned in writing by the Prime Minister.</p> <p>8. The Secretary General may delegate the tasks set out in paragraph 5 of this Article to the heads of offices within the Office of Prime Minister. In this case, he/she remains responsible for supervision of delegated tasks.</p> <p>9. The Secretary General shall create a register which defines the delegation acts, tasks and the areas of delegation, the person to whom they are delegated and the period of delegation.</p>	<p>Kancelarije premijera, u skladu sa važećim zakonodavstvom;</p> <p>5.7. bilo koju drugu odgovornost koja mu je dodeljena zakonom ili koju mu premijer izričito delegira.</p> <p>6. Generalnog sekretara podržava stručno i pomoćno osoblje.</p> <p>7. Generalnog sekretara, u slučaju odsustva, zamenjuje direktor jedne od Kancelarija u okviru Kancelarije premijera, koga je sam sekretar pismenim putem odredio. U slučaju zdravstvenih problema, direktora kancelarije koji zamenjuje generalnog sekretara pismenim putem određuje premijer.</p> <p>8. Generalni sekretar može delegirati dužnosti utvrđene u stavu 5. ovog člana, rukovodiocima kancelarije u okviru Kancelarije premijera. U ovom slučaju, snosi odgovornost za nadgledanje delegiranih dužnosti.</p> <p>9. Generalni sekretar kreira registar u kom se utvrđuju akti delegiranja, dužnosti i oblasti delegiranja, osobi kome je delegirana i period delegiranja.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 14 Ministritë</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Ministries</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Ministarstva</p>
<p>1. Qeveria e Kosovës përbëhet nga këto ministri:</p> <p>1.1. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD);</p> <p>1.2. Ministria e Integritimit Evropian (MIE);</p> <p>1.3. Ministria e Drejtësisë (MD);</p> <p>1.4. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);</p> <p>1.5. Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT);</p> <p>1.6. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP);</p> <p>1.7. Ministria e Ekonomisë, Punësimit Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS);</p> <p>1.8. Ministria e Mbrojtjes (MM);</p> <p>1.9. Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit (MIA);</p> <p>1.10. Ministria e Shëndetësisë (MSh);</p>	<p>1. The Government of the Republic of Kosovo shall consist of the following Ministries:</p> <p>1.1. Ministry of Foreign Affairs and the Diaspora (MFAD);</p> <p>1.2. Ministry of European Integration (MEI);</p> <p>1.3. Ministry of Justice (MoJ);</p> <p>1.4. Ministry of Education, Science, Technology and Innovation (MESTI);</p> <p>1.5. Ministry of Finance and Transfers (MFT);</p> <p>1.6. Ministry of Internal Affairs and Public Administration (MPBAP);</p> <p>1.7. Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investment (MEETIESI);</p> <p>1.8. Ministry of Defence (MoD);</p> <p>1.9. Ministry of Infrastructure and Environment (MIE);</p> <p>1.10. Ministry of Health (MoH);</p>	<p>1. Vlada Kosova sastoji se od sledećih ministarstava:</p> <p>1.1. Ministarstvo inostranih poslova i dijaspore (MIPD);</p> <p>1.2. Ministarstvo za evropske integracije (MIE);</p> <p>1.3. Ministarstvo pravde (MP);</p> <p>1.4. Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacija (MONTI);</p> <p>1.5. Ministarstvo finansija i transfera (MFT);</p> <p>1.6. Ministarstvo unutrašnjih poslova i javne uprave (MUPJU);</p> <p>1.7. Ministarstvo ekonomije, zapošljavanja, trgovine, industrije, preduzetništva i strateških ulaganja (MEZTIPSU);</p> <p>1.8. Ministarstvo odbrane (MO);</p> <p>1.9. Ministarstvo infrastrukture i životne sredine (MIŽS);</p> <p>1.10. Ministarstvo zdravstva (MZ);</p>

<p>1.11. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR);</p> <p>1.12. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS);</p> <p>1.13. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL);</p> <p>1.14. Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK);</p> <p>1.15. Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZhR).</p>	<p>1.11. Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development (MAFRD);</p> <p>1.12. Ministry of Culture, Youth and Sports (MCYS);</p> <p>1.13. Ministry of Local Government Administration (MLGA);</p> <p>1.14. Ministry for Communities and Returns (MCR);</p> <p>1.15. Ministry of Regional Development (MRD).</p>	<p>1.11. Ministarstvo poljoprivrede, šumarstva i ruralnog razvoja (MPŠRR);</p> <p>1.12. Ministarstvo kulture, omladine i sporta (MKOS);</p> <p>1.13. Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS);</p> <p>1.14. Ministarstvo za zajednice i povratak (MZP);</p> <p>1.15. Ministarstvo za regionalni razvoj (MRR).</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15 Fushat specifike të përgjegjësisë së ministrive</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Specific areas of responsibility of ministries</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Specifične oblasti odgovornosti ministarstava</p>
<p>Fushat e përgjegjësiwe administrative të ministrive janë përcaktuar në shtojca, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.</p>	<p>The areas of administrative responsibilities of the ministries are set out in Annexes, which are an integral part of this regulation.</p>	<p>Oblasti administrativne odgovornosti ministarstava navedene su u priložima, koji su sastavni deo ove uredbe.</p>

<p>KAPITULLI IV - KABINETI I KRYEMINISTRIT, ZËVENDËSKRYEMINISTRAVE DHE MINISTRAVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Kabinetet</p> <p>1. Kabineti i Kryeministrit përfshin: Kryeministrin, zëvendëskryeministrat, këshilltarët politikë të Kryeministrit, këshilltarët politikë të zëvendëskryeministrave, si dhe nëpunësit e punësuar në kabinete.</p> <p>2. Kabineti i ministrit përfshin: ministrin, zëvendësministrin, këshilltarët politikë të ministrave dhe nëpunësit e punësuar në kabinete.</p> <p style="text-align: center;">Neni 17 Kabineti i Kryeministrit</p> <p>Kryeministrit i ndihmon stafi i Kabinetit të tij që përbëhet prej këshilltarëve politikë dhe nëpunësve të kabinetit, sipas zgjedhjes së tij. Ky staf është përgjegjës për t'i ofruar ndihmë Kryeministrit lidhur me përkufizimin e vijave të përgjithshme të politikës së Qeverisë dhe për bashkërendimin e punëve të tij.</p>	<p>CHAPTER IV - CABINET OF PRIME MINISTER, DEPUTY PRIME MINISTERS AND MINISTERS</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Cabinets</p> <p>1. The Cabinet of the Prime Minister shall include: the Prime Minister, Deputy Prime Ministers, Political Advisors of the Prime Minister, and Political Advisors of Deputy Prime Ministers and officers employed in the Cabinets.</p> <p>2. The cabinet of the Minister shall include: the minister, the deputy minister, the political advisors of ministers and the officers employed in the cabinets.</p> <p style="text-align: center;">Article 17 Cabinet of the Prime Minister</p> <p>The Prime Minister shall be assisted by his Cabinet staff which consists of political advisors and cabinet officials of his choice. This sector shall be responsible for providing assistance to the Prime Minister concerning the definitions of general lines of Government policy and to coordinate its work.</p>	<p>POGLAVLJE IV - KABINET PREMIJERA, ZAMENIKA PREMIJERA I MINISTARA</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Kabineti</p> <p>1. Kabinet premijera obuhvata: premijera, zamenike premijera, političke savetnik premijera, političke savetnike zamenika premijera, kao ni službenike zaposlene u kabinetima.</p> <p>2. Kabinet ministra obuhvata: ministra, zamenika ministra, političke savetnike ministara i službenike zaposlene u kabinetima.</p> <p style="text-align: center;">Član 17 Kabinet premijera</p> <p>Premijeru pomaže osoblje njegovog Kabineta koji čine politički savetnici i službenici kabineta, koje on bira. Ovo osoblje je odgovorno za pružanje pomoći premijeru vezano za definisanje opštih linija politike Vlade i za koordinaciju njegovih poslova.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 18 Këshilltari politik</p> <p>1. Këshilltari politik është kategori e veçantë e zyrtarit publik, i cili:</p> <p>1.1. Emërohet drejtpërdrejt nga Kryeministri, zëvendëskryeministri, apo ministri (në tekstin në vijim: eprori) dhe i pushon mandati me përfundimin e mandatit të eprorit të tij, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët;</p> <p>1.2. Për veprimet e veta i përgjigjet eprorit të tij dhe emërimi i tij është personal;</p> <p>1.3. Demonstron lojalitet dhe përkushtim politik ndaj eprorit të tij;</p> <p>1.4. Është njohës i mirë i fushës për të cilën është emëruar.</p> <p>2. Këshilltari politik nuk ushtron kompetenca drejtuese ose kompetenca të tjera administrative.</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 Political advisor</p> <p>1. The political advisor shall be a special category of public official who:</p> <p>1.1. Is appointed directly by the Prime minister, the Deputy Prime Minister, or the Minister (hereinafter: “the superior”) and his/her mandate expires with the completion of the mandate of his/her superior, unless terminated earlier;</p> <p>1.2. Is accountable for his/her actions and his/her appointment is personal;</p> <p>1.3. Demonstrates loyalty and political commitment to his/her superior;</p> <p>1.4. Is a good connoisseur of the field he/she is appointed for.</p> <p>2. The political advisor does not exercise management or other administrative competencies.</p>	<p style="text-align: center;">Član 18 Politički savetnik</p> <p>1. Politički savetnik je posebna kategorije javnog zvaničnika, koji je:</p> <p>1.1. Direktno imenovan od strane premijera, zamenika premijera, ili ministra (u daljem tekstu: nadređeni) i kome mandat prestaje sa prestankom mandata njegovog nadređenog, osim ako se taj radni odnos ne prekine ranije;</p> <p>1.2. O svom delovanju odgovora svom nadređenom, a njegovo imenovanje je lično;</p> <p>1.3. Pokazuje političku odanost i posvećenost prema svom nadređenom;</p> <p>1.4. Dobar je poznavalac oblasti za koju je imenovan.</p> <p>2. Politički savetnik ne vrši upravljачke ili druge administrativne nadležnosti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 19 Numri i këshilltarëve politikë</p> <p>1. Kryeministri mund të emërojë deri në pesëmbëdhjetë (15) këshilltarë politikë.</p> <p>2. Kryeministri, gjithashtu mund të emërojë</p>	<p style="text-align: center;">Article 19 Number of political advisors</p> <p>1. The Prime Minister may appoint up to fifteen (15) political advisors.</p> <p>2. The Prime Minister may also appoint up to one (1)</p>	<p style="text-align: center;">Član 19 Broj političkih savetnika</p> <p>1. Premijer može da imenuje do petnaest (15) političkih savetnika.</p> <p>2. Premijer, takođe može da imenuje i po</p>

<p>edhe nga një (1) këshilltar politik për secilin nga komunitetet nga radha e komunitetit serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran, malazez dhe kroat.</p> <p>3. Zëvendëskryeministri i parë mund të emërojë deri në dhjetë (10) këshilltarë politikë.</p> <p>4. Zëvendëskryeministri pa funksion ministror mund të emërojë deri në dhjetë (10) këshilltarë politikë.</p> <p>5. Zëvendëskryeministri, që mbulon një ministri, mund të emërojë deri në dhjetë (10) këshilltarë politikë.</p> <p>6. Ministri mund të emërojë deri në gjashtë (6) këshilltarë politikë. Postet e këshilltarëve të autorizuar sipas këtij paragrafi mund t'i ndahen edhe zëvendësministrave nga ministri përkatës.</p> <p>7. Zëvendëskryeministrat, që mbulojnë ministri dhe ministrat, gjithashtu mund të emërojnë një (1) këshilltar politik nga komunitetet.</p>	<p>political advisors for each of the Serb, Turkish, Bosnian, Roma, Ashkali, Egyptian, Gorani, Montenegrin and Croatian communities.</p> <p>3. First Deputy Prime Minister may appoint up to ten (10) political advisors.</p> <p>4. Deputy Prime Minister without ministerial function may appoint up to ten (10) political advisors.</p> <p>5. Deputy Prime Minister, that covers a ministry, may appoint up to ten (10) political advisors.</p> <p>6. The Minister may appoint up to six (6) political advisors. Posts of advisors authorized under this paragraph may be allocated to deputy ministers by the relevant Minister.</p> <p>7. Deputy Prime Ministers, that cover ministries and Ministers, may also appoint one (1) political advisors from communities.</p>	<p>jedan (1) političkog savetnika iz svake zajednice, iz redova srpske, turske, bošnjačke, romske, aškalijske, egipćanske, goranske, crnogorske i hrvatske zajednice.</p> <p>3. Prvi zamenik premijera može da imenuje do deset (10) političkih savetnika.</p> <p>4. Zamenik premijera bez ministarske funkcije može da imenuje do deset (10) političkih savetnika.</p> <p>5. Zamenik premijera koji pokriva jedno ministarstvo, može da imenuje do deset (10) političkih savetnika.</p> <p>6. Ministar može da imenuje do šest (6) političkih savetnika. Funkcije savetnika koje su ovlašćene u skladu sa ovim stavom mogu se dodeliti i zamenicima premijera od strane nadležnog ministra.</p> <p>7. Zamenici premijera koji pokrivaju ministarstva i ministri, takođe mogu da imenuju jedan (1) političkih savetnika iz zajednica.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 20 Kompetencat dhe përgjegjësitë e këshilltarit politik</p> <p>1. Këshilltari politik mbështet dhe këshillon eprorin e tij në ushtrimin e përgjegjësisë së tij në:</p>	<p style="text-align: center;">Article 20 Competencies and responsibilities of the political advisor</p> <p>1. The Political Advisor shall support and advise his superior in performing his/her responsibilities in:</p>	<p style="text-align: center;">Član 20 Ovlašćenja i odgovornosti političkog savetnika</p> <p>1. Politički savetnik podržava i savetuje svog nadređenog u vršenju svojih nadležnosti u:</p>

<p>1.1. formulimin dhe zhvillimin e politikave;</p> <p>1.2. zbatimin e politikave;</p> <p>1.3. vlerësimin e efektshmërisë së politikave dhe prezantimin e tyre;</p> <p>1.4. përgatitjen e fjalimeve dhe prezantimeve varësisht nga nevojat dhe specifikat e temave.</p> <p>2. Këshilltari politik i raporton drejtpërdrejtë eprorit të tij.</p>	<p>1.1. policy formulation and development;</p> <p>1.2. implementation of policies;</p> <p>1.3. evaluating the effectiveness of policies, and their presentation;</p> <p>1.4. preparing speeches and presentations depending on the needs and specifics of the topics.</p> <p>2. The Political Advisor shall report directly to his/her superior.</p>	<p>1.1. formulisanju i razvoju politike;</p> <p>1.2. sprovođenju politike;</p> <p>1.3. ocenjivanju efikasnosti politike i njenoj prezentaciji;</p> <p>1.4. pripremanju govora i prezentacija u zavisnosti od potreba i specifičnosti tema.</p> <p>2. Politički savetnika izveštava direktno svom nadređenom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 21 Sjellja e këshilltarit politik</p> <p>1. Këshilltarit politik nuk i lejohet:</p> <p>1.1. të ushtrojë çfarëdo pushteti ligjor, për ushtrimin e të cilit është kompetent eprori i tij;</p> <p>1.2. të ushtrojë çfarëdo funksioni tjetër, që ndërlidhet me menaxhimin e shërbimit civil;</p> <p>1.3. të ndërhyrje në cilindo funksion tjetër i cili ushtrohet nga shërbimi civil;</p> <p>1.4. të ndërhyjë në funksionet të cilat me legjislacionin përkatës i janë përcaktuar shërbimit civil;</p>	<p style="text-align: center;">Article 21 Conduct of the Political Advisor</p> <p>1. A political adviser shall not be allowed to:</p> <p>1.1. exercise any legal authorities, for which his/her superior is competent;</p> <p>1.2. exercise any other function, related to civil service management;</p> <p>1.3. interfere with any other function which is exercised by the civil service;</p> <p>1.4. interfere with the functions provided by law on the civil service;</p>	<p style="text-align: center;">Član 21 Ponašanje političkog savetnika</p> <p>1. Političkom savetniku nije dozvoljeno:</p> <p>1.1. da vrši pravnu vlast, za čije je obavljanje nadležan njegov nadređeni.</p> <p>1.2. da vrši bilo koju drugu funkciju, koja se odnosi na upravljanje civilnom službom;</p> <p>1.3. da se meša u bilo koju drugu funkciju koju vrši civilna služba;</p> <p>1.4. da se meša u funkcijama koje su relevantnim zakonodavstvom dodeljene civilnoj službi;</p>

<p>1.5. të ushtrojë kompetenca ligjore, të cilat duhet të ushtrohen nga eprori i tyre, Zyra e Kryeministrit ose ministritë;</p> <p>1.6. të autorizojë shpenzimin e fondeve publike;</p> <p>1.7. t’iu jep udhëzime nëpunësve civil.</p> <p>2. Këshilltari politik dhe nëpunësi në kabinet obligohet të respektojë Kodin e Mirësjelljes për të Emëruarit Politik i cili propozohet nga Zyra e Kryeministrit dhe miratohet nga Qeveria.</p>	<p>1.5. exercise legal authorities to be exercised by their superiors, the Office of the Prime Minister or ministries;</p> <p>1.6. authorize the expenditure of public funds;</p> <p>1.7. provide guidance to civil servants.</p> <p>2. The Political Advisor and Cabinet Officer shall be required to abide by the Code of Conduct for Political Appointees proposed by the Office of the Prime Minister and approved by the Government.</p>	<p>1.5. da vrši zakonske nadležnosti, koje treba da vrši njegov nadređeni, Kancelarija premijera ili ministarstva;</p> <p>1.6. ovlašćuje trošenje javnih sredstava;</p> <p>1.7. daje uputstva civilnim službenicima.</p> <p>2. Politički savetnik ili službenik u kabinetu dužan je da poštuje Kodeks ponašanja političkih imenovanih lica, kojeg predlaže Kancelarija premijera, i usvaja Vlada.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 22 Ankesat ndaj këshilltarit politik</p> <p>1. Çdo qytetar dhe nëpunës civil ka të drejtë të ankohet lidhur me veprimet e një këshilltari politik.</p> <p>2. Ankesa duhet t’i drejtohet eprorit të këshilltarit politik.</p> <p>3. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas paraqitjes së ankesës, eprori i këshilltarit kthen përgjigjen te ankuesi.</p>	<p style="text-align: center;">Article 22 Complaints against the political advisor</p> <p>1. Every citizen and Civil Servant has rights to complain about the actions of a political advisor.</p> <p>2. Any such complaint must be addressed to the superior of the political advisor.</p> <p>3. Within fifteen (15) days of the filing of the complaint, the superior of the advisor shall respond to the complainant.</p>	<p style="text-align: center;">Član 22 Žalbe protiv političkog savetnika</p> <p>1. Svaki građanin i civilni službenik ima pravo da se žali na postupke političkog savetnika.</p> <p>2. Žalba treba da se uputi nadređenom političkog savetnika.</p> <p>3. U roku od petnaest (15) dana od podnošenja žalbe, nadređeni savetnika vraća odgovor podnosiocu žalbe.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 23 Shefi i Stafit</p> <p>1. Kryeministri njërin nga këshilltarët e tij e emëron Shef të Stafit të Kryeministrit, i cili</p>	<p style="text-align: center;">Article 23 Chief of Staff</p> <p>1. Prime Minister shall appoint one of the advisors as Chief of Staff and Deputy Chief of Staff of Cabinet of</p>	<p style="text-align: center;">Član 23 Šef osoblja</p> <p>1. Premijer imenuje jednog od svojih savetnika za Šefa osoblja premijera, koji je</p>

<p>njëkohësisht është Këshilltar i Lartë i Kryeministrit.</p> <p>2. Shefi i Stafit është përgjegjës që t'i ofrojë ndihmë Kryeministrit në bashkërendimin e punëve dhe koordinimin me këshilltarët e Kryeministrit si dhe këshilltarët politikë të zëvendëskryeministrave dhe ministrave.</p> <p>3. Shefi i Stafit siguron që të mbahet një regjistër me emrat dhe funksionet e veçanta të të gjithë këshilltarëve politikë në Qeverinë e Republikës së Kosovës.</p> <p>4. Pas secilit emërim, eprori përkatës njofton Shefin e Stafit me emrat e këshilltarëve politikë dhe me funksionet specifike që u janë dhënë atyre. Njoftimi për emërim të këshilltarëve politikë duhet bërë në afat prej tre (3) ditëve, nga dita e emërimit të tyre.</p> <p>5. Shefi i Stafit vërteton nëse këshilltarët politikë janë emëruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.</p> <p>6. Shefi i Stafit koordinon punën me të gjithë këshilltarët e lartë të zëvendëskryeministrave dhe ministrave dhe mban takime të rregullta me ta së paku një herë në muaj.</p> <p>7. Kryeministri mund të emërojë njërin nga këshilltarët e tij, zëvendës Shef të Stafit të Kryeministrit.</p>	<p>the Prime Minister.</p> <p>2. Chief of Staff shall be responsible to provide assistance to Prime Minister in coordination of works and coordination of advisors of OPM and political advisors of Deputy Prime Ministers and Ministers.</p> <p>3. Chief of Staff ensures to keep a register with names and specific functions of all political advisors in the Republic of Kosovo.</p> <p>4. After each appointment, the respective superior shall notify Chief of Staff with the names of political advisors and with the specific functions assigned to them. Notice of appointment of political advisors should be made within 3 days, from the date of their appointment.</p> <p>5. Chief of Staff shall verify if political advisors are appointed in accordance with the provisions in force.</p> <p>6. Chief of Staff shall coordinate the work with all senior political advisors and holds regular meetings with them at least once a month.</p> <p>7. The Prime Minister may appoint one of his advisers as the Deputy Chief of Staff to the Office of Prime Minister.</p>	<p>ujedno i Viši savetnik premijera.</p> <p>2. Šef osoblja je odgovoran da pruža pomoć premijeru u koordinaciji rada i koordinaciji sa savetnicima premijera, kao i sa političkim savetnicima zamenika premijera i ministara.</p> <p>3. Šef osoblja obezbeđuje da se vodi registar sa imenima i posebnim funkcijama svih političkih savetnika u Vladi Republike Kosovo.</p> <p>4. Nakon svakog imenovanja, relevantni nadređeni saopštava Šefu osoblja imena političkih savetnika i specifične funkcije koje su dodeljene njima. Obaveštenje o imenovanju političkih savetnika treba uraditi u roku od tri (3) dana, od dana njihovog imenovanja.</p> <p>5. Šef osoblja proverava da li su politički savetnici imenovani u skladu sa važećim zakonskim odredbama.</p> <p>6. Šef osoblja koordinira rad sa svim višim savetnicima zamenika premijera i ministara i održava redovne sastanke sa njima, najmanje jednom mesečno.</p> <p>7. Premijer može da imenuje jednog od svojih savetnika za Zamenika šefa osoblja premijera.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 24 Kabineti i zëvendëskryeministrit</p> <p>Zëvendëskryeministrit i ndihmon stafi i Kabinetit të tij që përbëhet prej këshilltarëve politikë dhe nëpunësve të kabinetit, sipas zgjedhjes së tij. Ky staf është përgjegjës për t'i ofruar ndihmë zëvendëskryeministrit lidhur me përkufizimin e vijave të përgjithshme të politikës së Qeverisë dhe për bashkërendimin e punëve të tij.</p>	<p style="text-align: center;">Article 24 Cabinet of the Deputy Prime Minister</p> <p>The Deputy Prime Minister shall be assisted by his Cabinet staff, consisting of political advisers and cabinet officials, according to his choice. This staff shall be responsible for assisting the Deputy Prime Minister in defining the outlines of the Government's policy and coordinating its work.</p>	<p style="text-align: center;">Član 24 Kabinet zamenika premijera</p> <p>Zameniku premijera pomaže osoblje svog Kabineta kojeg čine politički savetnici i službenici kabineta, po njegovom izboru. Ovo osoblje je odgovorno za pružanje pomoći zameniku premijera u vezi sa definisanjem opštih linija politike Vlade i koordinacijom njegovo rada.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 25 Kabineti i ministrit</p> <p>Ministrit i ndihmon stafi i Kabinetit të tij që përbëhet prej këshilltarëve politikë dhe nëpunësve të kabinetit, sipas zgjedhjes së tij. Ky staf është përgjegjës për t'i ofruar ndihmë ministrit lidhur me përkufizimin e vijave të përgjithshme të politikës së ministrisë dhe për bashkërendimin e punëve të tij.</p>	<p style="text-align: center;">Article 25 Cabinet of the Minister</p> <p>The Minister is assisted by his Cabinet staff consisting of political advisers and Cabinet officers of his/her choice. This staff is responsible for assisting the Minister in defining the outline of the ministry's policy and coordinating his/her work.</p>	<p style="text-align: center;">Član 25 Kabinet ministra</p> <p>Ministru pomaže osoblje svog Kabineta kojeg čine politički savetnici i službenici kabineta, po njegovom izboru. Ovo osoblje je odgovorno za pružanje pomoći ministru u vezi sa definisanjem opštih linija politike ministarstva i koordinacijom njegovo rada.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 26 Emërimi i këshilltarit politik</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kryeministri emëron njërin nga këshilltarët politikë Zëdhënës të Qeverisë. 2. Ministri emëron njërin nga këshilltarët politikë Zëdhënës të Ministrisë. 3. Zëvendëskryeministri dhe ministri emërojnë 	<p style="text-align: center;">Article 26 Appointment of Political Advisor</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. The Prime Minister shall appoint one of the political advisors as a spokesperson of the Government. 2. The Minister shall appoint one of the Political Spokesmen of the Ministry. 3. Deputy Prime Minister and Minister shall appoint one 	<p style="text-align: center;">Član 26 Imenovanje političkog savetnika</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Premijer imenuje jednog od svojih političkih savetnika za Portparola Vlade. 2. Ministar imenuje jednog od svojih političkih savetnika za Portparola ministarstva. 3. Zamenik premijera i ministar imenuju

<p>njërën nga këshilltarët politikë në cilësinë e Këshilltarit të Lartë Politik.</p> <p>4. Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministri emërojnë njërën nga këshilltarët politikë në cilësinë e Shefit të Kabinetit.</p> <p>5. Këshilltari i Lartë Politik koordinon punën e këshilltarëve politikë, bën ndarjen e përgjegjësisë dhe detyrave dhe përcakton procedurat e punës së ekipit të këshilltarëve politikë.</p> <p>6. Shefi i Kabinetit të Kryeministrit koordinon punën me të gjithë shefat e kabineteve të ministrave.</p>	<p>of the political advisors in the capacity of Senior Political Advisor.</p> <p>4. Prime Minister, Deputy Prime Minister and Minister shall appoint one of the political advisors in the capacity of Chief of Cabinet.</p> <p>5. Senior Political Advisor shall coordinate the work of political advisors, allocates responsibilities and duties, and sets out the working procedure of the team of political advisors.</p> <p>6. Chief of the Cabinet of the Prime Minister shall coordinate the work with the chiefs of ministerial cabinets.</p>	<p>jednog od političkih savetnika za Višeg političkog savetnika.</p> <p>4. Premijer, zamenik premijera i ministar imenuju jednog od političkog savetnika za Šefa kabineta.</p> <p>5. Viši politički savetnik koordinira rad političkih savetnika, vrši dodelu odgovornosti i dužnosti i utvrđuje radne procedure tima političkih savetnika.</p> <p>6. Šef kabineta premijera koordinira rad sa svim šefovima kabineta ministara.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 27 Këshilltari i jashtëm politik</p>	<p style="text-align: center;">Article 27 External political adviser</p>	<p style="text-align: center;">Član 27 Spoljni politički savetnik</p>
<p>1. Këshilltari i jashtëm politik është kategori e veçantë e zyrtarit publik, i cili:</p> <p>1.1. Emërohet drejtpërdrejt nga Kryeministri, zëvendëskryeministri, apo ministri (në tekstin në vijim: eprori) dhe i pushon mandati me përfundimin e mandatit të eprorit të tij, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët;</p> <p>1.2. Për veprimet e veta i përgjigjet eprorit të tij dhe emërimi i tij është personal;</p>	<p>1. The external political adviser is a separate category of the public official, who shall:</p> <p>1.1. Be appointed directly by the Prime Minister, Deputy Prime Minister, or Minister (hereinafter: the superior) and his mandate ceases upon the termination of his superior's mandate; unless this employment relationship is terminated earlier;</p> <p>1.2. Report to his superior for their own actions, and his appointment is personal;</p>	<p>1. Spoljni politički savetnik je posebna kategorija javnog zvaničnika, koji se:</p> <p>1.1. Imenuje direktno od strane premijera, zamenika premijera ili ministra (u daljem tekstu: nadređeni) i prestaje mu mandat završetkom mandata svog nadređenog, ako se ovaj radni odnos ne prekine ranije;</p> <p>1.2. Za svoje postupke odgovara svom nadređenom i njegovo imenovanje je lično;</p>

<p>1.3. Demonstron lojalitet dhe përkushtim politik ndaj eprorit të tij;</p> <p>1.4. Është njohës i mirë i fushës për të cilën është emëruar.</p> <p>2. Këshilltari i jashtëm politik nuk ushtron kompetenca drejtuese ose kompetenca të tjera administrative.</p> <p>3. Këshilltari i jashtëm politik mbështet dhe këshillon eprorin e tij në ushtrimin e përgjegjësiave të tij në:</p> <p>3.1. formulimin dhe zhvillimin e politikave;</p> <p>3.2. zbatimin e politikave;</p> <p>3.3. vlerësimin e efektshmërisë së politikave dhe prezantimin e tyre;</p> <p>3.4. përgatitjen e fjalimeve dhe prezantimeve varësisht nga nevojat dhe specifikat e temave.</p> <p>4. Këshilltari i jashtëm politik i raporton drejtpërdrejtë eprorit të tij.</p> <p>5. Këshilltari i jashtëm politik i përgatit fjalimet dhe prezantimet e eprorit të tij varësisht nga nevojat dhe specifikat e temave.</p> <p>6. Pas secilit emërim, eprori përkatës duhet ta njoftojë Shefin e Stafit me emrat e këshilltarëve të jashtëm politikë. Njoftimi për</p>	<p>1.3. Demonstrate loyalty and political commitment to his superior;</p> <p>1.4. Have good knowledge on the field for which it is appointed.</p> <p>2. The external political adviser shall not exercise any management or other administrative powers.</p> <p>3. The external political adviser shall support and advise his superior in the exercise of his responsibilities regarding:</p> <p>3.1. policy formulation and development;</p> <p>3.2. policy implementation;</p> <p>3.3. evaluating the effectiveness of policies and their presentation;</p> <p>3.4. preparing speeches and presentations, depending on the needs and specifics of the topics.</p> <p>4. The external political adviser shall report directly to his superior.</p> <p>5. The external political adviser shall prepare speeches and presentations of his superior, depending on the needs and specifics of the topics.</p> <p>6. The relevant superior, after each appointment, shall notify the Chief of Staff on the names of external political advisers. The notice of appointment of external</p>	<p>1.3. Pokazuje lojalnost i političku odanost prema svom nadređenom;</p> <p>1.4. Dobar je poznavalac oblasti za koju je imenovan.</p> <p>2. Spoljni politički savetnik ne vrši upravljačke nadležnosti ili druge nadležnosti uprave.</p> <p>3. Spoljni politički savetnik podržava i savetuje svog nadređenog u vršenju svojih nadležnosti u:</p> <p>3.1. formulisanju i razvoju politike;</p> <p>3.2. sprovođenju politike;</p> <p>3.3. proceni efikasnosti politike i njenoj prezentaciji;</p> <p>3.4. pripremanju govora i prezentacija u zavisnosti od potreba i specifičnosti tema</p> <p>4. Spoljni politički savetnik izveštava direktno svom nadređenom.</p> <p>5. Spoljni politički savetnik priprema govore i prezentacije svog nadređenog u zavisnosti od potreba i specifičnosti tema.</p> <p>6. Nakon svakog imenovanja, relevantni nadređeni saopštava Šefu osoblja imena spoljnih političkih savetnika. Obaveštenje o</p>
---	---	---

<p>emërim të këshilltarëve të jashtëm politikë duhet bërë në afat prej tre (3) ditësh, nga dita e emërimit të tyre.</p> <p>7. Këshilltarët e jashtëm politikë nuk paguhen nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nuk shkaktojnë shpenzime për Buxhetin e Kosovës.</p> <p>8. Përjashtimisht nga paragrafi 7 i këtij neni, nëse eprori e sheh të arsyeshme mund ta autorizojë pjesëmarrjen e Këshilltarit të jashtëm në ndonjë udhëtim zyrtar jashtë vendit dhe me këtë rast shpenzimet e udhëtimit do të mbulohen nga buxheti i institucionit, në qoftëse nuk mund të sigurohet financim tjetër.</p>	<p>political advisers should be made within three (3) days, from the day of their appointment.</p> <p>7. The external political adviser shall not be paid from the Budget of the Republic of Kosovo and do not incur expenses to the Budget of Kosovo.</p> <p>8. Notwithstanding paragraph 7 of this Article, if the supervisor considers it appropriate, he may authorize the participation of the External Adviser in any business travel abroad and in such cases, travel expenses shall be covered by the institution's budget if no other funding can be provided.</p>	<p>imenovanju spoljnih političkih savetnika treba uraditi u roku od tri (3) dana, od dana njihovog imenovanja.</p> <p>7. Spoljni politički savetnici se ne plaćaju iz budžeta Republike Kosovo i ne stvaraju troškove kosovskom budžetu.</p> <p>8. Izuzev iz stava 7. ovog člana, ako nadređeni vidi opravdanim, može odobriti učešće spoljnog savetnika u nekom službenom putovanju u inostranstvu i ovom prilikom troškovi putovanja biće pokriveni iz budžeta institucije, ako se ne mogu obezbediti druga ostalo finansiranje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 28 Numri i këshilltarëve të jashtëm politikë</p> <p>1. Kryeministri mund të emërojë deri në dhjetë (10) këshilltarë të jashtëm politikë.</p> <p>2. Zëvendëskryeministri mund të emërojë deri në pesë (5) këshilltarë të jashtëm politikë.</p> <p>3. Ministri mund të emërojë deri në tre (3) këshilltarë të jashtëm politikë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 28 Number of external political advisers</p> <p>1. The Prime Minister may appoint up to ten (10) external political advisers.</p> <p>2. The Deputy Prime Minister may appoint up to five (5) external political advisers.</p> <p>3. The Minister may appoint up to three (3) external political advisers.</p>	<p style="text-align: center;">Član 28 Broj spoljnih političkih savetnika</p> <p>1. Premijer može da imenuje do deset (10) spoljnih političkih savetnika.</p> <p>2. Zamenik premijera može da imenuje do pet (5) spoljnih političkih savetnika.</p> <p>3. Ministar može da imenuje do tri (3) spoljnih političkih savetnika.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 29 Nëpunësit në Kabinete</p> <p>1. Nëpunësit në kabinete janë kategori e veçantë e zyrtarëve publikë, të cilët ofrojnë</p>	<p style="text-align: center;">Article 29 Officials in Cabinets</p> <p>1. Officials in cabinets are a separate category of public officials who provide administrative technical</p>	<p style="text-align: center;">Član 29 Službenici u kabinetima</p> <p>1. Službenici u kabinetima su posebna kategorija javnih zvaničnika, koji pružaju</p>

<p>mbështetje administrative teknike.</p> <p>2. Numri i nëpunësve në kabinete është si në vijim:</p> <p>2.1. Kryeministri mund të emërojë deri në pesëmbëdhjetë (15) nëpunës në Kabinet;</p> <p>2.2. Zëvendëskryeministri mund të emërojë deri në gjashtë (6) nëpunës në Kabinet;</p> <p>2.3. Ministri mund të emërojë deri në katër (4) nëpunës në Kabinet;</p> <p>2.4. Zëvendësministri mund të emërojë deri në dy (2) nëpunës në Kabinet.</p> <p>3. Nëpunësit në kabinet të Kryeministrit, zëvendëskryeministrave, dhe ministrave nuk janë nëpunës civil dhe u pushon mandati me përfundimin e mandatit të eprorit të tyre nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.</p>	<p>support.</p> <p>2. The number of employees in the cabinets shall be as follows:</p> <p>2.1. The Prime Minister may appoint up to fifteen (15) officials in the Cabinet;</p> <p>2.2. The Deputy Prime Minister may appoint up to six (6) officials in the Cabinet;</p> <p>2.3. The Minister may appoint up to four (4) officials in the Cabinet;</p> <p>2.4. The Deputy Minister may appoint up to two (2) officials in the Cabinet.</p> <p>3. Officials of the cabinet of the Prime Minister, Deputy Prime Ministers, and Ministers are not civil servants and their mandate ceases upon the termination of their superior's mandate, unless this employment relationship is terminated earlier.</p>	<p>administrativnu i tehničku podršku</p> <p>2. Broj službenika u kabinetima je kao u nastavku:</p> <p>2.1. Premijer može da imenuje do petnaest (15) službenika u Kabinetu;</p> <p>2.2. Zamenik premijera može da imenuje do šest (6) službenika u Kabinetu;</p> <p>2.3. Ministar može da imenuje do četiri (4) službenika u Kabinetu;</p> <p>2.4. Zamenik ministra može da imenuje do dva (2) službenika u Kabinetu.</p> <p>3. Službenici u kabinetu premijera, zamenika premijera i ministara nisu civilni službenici, i prestaje im mandat sa završetkom mandata njihovih nadređenih, ako se ovaj radni odnos ne prekine ranije.</p>
<p>KAPITULLI V - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE</p> <p>Neni 30 Dispozitat kalimtare</p> <p>1. Brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, me propozimin e Zyrës së Kryeministrit, Qeveria miraton Kodin e Mirësjelljes për të Emëruarit Politikë.</p>	<p>CHAPTER V – FINAL PROVISIONS</p> <p>Article 30 Transitional Provisions</p> <p>1. Within six (6) months of the entry into force of this Regulation, on the proposal of the Office of the Prime Minister, the Government shall adopt a Code of Conduct for Political Appointees.</p>	<p>POGLAVLJE V – ZAVRŠNE ODREDBE</p> <p>Član 30 Prelazne odredbe</p> <p>1. U roku od šest (6) meseci od stupanja na snagu ove uredbe, na predlog Kancelarije premijera, Vlada usvaja Kodeks ponašanja političkih imenovanih lica.</p>

<p>2. Kodi i mirësjelljes për të Emëruarit Politikë (sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2005) vazhdon të zbatohet deri në nxjerrjen e një Kodi tjetër nga ana e Qeverisë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 31 Shfuqizimi</p> <p>Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (GZ, Nr. 1/2011, dt. 18.04.2011) e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, Rregulloren Nr. 16/2017, Rregulloren Nr. 07/2018, Rregulloren Nr. 26/2018, dhe Rregulloren Nr. 30/2018.</p>	<p>2. Code of Conduct for Political Appointees (according to Administrative Instruction No. 02/2005) continues to apply until a further Code is issued by the Government.</p> <p style="text-align: center;">Article 31 Repeal</p> <p>With the entry into force of this Regulation, Regulation No. 02/2011 on the Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries (OG, No. 1/2011, dated 18.04.2011) amended and supplemented by Regulation No. 15/2017, Regulation No. 16/2017, Regulation No. 07/2018, Regulation No. 26/2018, and Regulation No. 30/2018, shall be repealed.</p>	<p>2. Kodeks ponašanja političkih imenovanih lica (u skladu sa Administrativnim uputstvom br. 02/2005) i dalje se sprovodi do donošenja novog Kodeksa od strane Vlade.</p> <p style="text-align: center;">Član 31 Ukidanje</p> <p>Stupanjem na snagu ove uredbe, ukida se Uredba br. 02/2011 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava (SL br. 1/2011, od 18.04.2011), izmenjena i dopunjena Uredbom br. 15/2017, Uredbom br. 16/2017, Uredbom br. 07/2018, Uredbom br. 26/2018 i Uredbom br. 30/2018.</p>
